

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Janar



01

NDRYSHIMET NË LIGJIN “PËR RININË” I HAPIN RRUGË PROGRAMIT TË TALENTEVE, NISMAVE KOMUNITARE DHE SJELLIN RISI NË PROGRAMIN KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS

Ministrja e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Znj. Bora Muzhaqi, njoftoi miratimin e shtesave dhe ndryshimeve në Projektligjin për Rininë në mbledhjen e Këshillit të Ministrave. Këto ndryshime vijnë si përfundim i një turi të gjatë konsultimesh me aktorë kyç të shoqërisë civile, duke përfshirë organizatat rinore dhe Këshillat Rinorë Vendorë, dhe synojnë të zgjerojnë mbështetjen për të rinjtë anembanë vendit.

Ky projektligj hap rrugën për dy programe të reja që do të fuqizojnë të rinjtë si aktorë të ndryshimeve në komunitetet e tyre. Ndër to, Programi i Nismave Komunitare, i cili u mundëson të rinjve të kthejnë idetë e tyre në projekte konkrete, të cilat mund të zbatohen me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë.

Përveç kësaj, Programi Kombëtar i Praktikave të Punës, i cili zbatohet tashmë prej 9 vitesh, do të përfshijë trajnime të thelluara nga Shkolla e Administratës Publike për të rinjtë, duke përgatitur brezin e ri për sfidat e tregut të punës dhe duke ofruar një kompensim për ushqimin gjatë periudhës së praktikës.



REPUBLIKA E SHQIPËS
KRIVEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Janar



02

SUKSESI I PROGRAMIT TË KODIMIT NË SHKOLLA PËR FËMIJËT, ZHVILLOJMË AFTËSITË KRITIKE DHE LOGJIKE TË FËMIJËVE

Në vijim të përkushtimit për inovacionin në arsim, Ministrja e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Znj. Bora Muzhaqi, zhvilloi një seri vizitash në shkolla të ndryshme për të parë përparimin dhe impaktin e Programit të Kodimit në Shkolla. Ky program tashmë ka përfshirë mbi 300 institucione arsimore në të gjithë vendin, duke transformuar mënyrën sesi fëmijët mësojnë dhe zhvillojnë aftësi të reja.

Gjatë këtij muaji Ministrja zhvilloi vizita në shkollën "Naim Frashëri", shkollën "Ptoleme Xhuvani" dhe shkollën "9 vjeçare Marqinetë", ku monitoroi zhvillimin e lëndës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit me klasat e para dhe të pesta, në laboratorët inteligjentë dhe modern të ndërtuar rishtazi për ti ofruar mundësi të barabarta në aksesin teknologjik fëmijëve. Me anë të këtij program fëmijët mësojnë teknologjinë dhe inteligjencën artificiale, duke e bërë kodimin jo vetëm më tërheqës përmes lojës dhe duke zhvilluar aftësitë kritike dhe logjike të ta.



03

ZHVILLIMI I TALENTEVE PËRMES PROGRAMIT KOMBËTAR TË AKTIVITETEVE JASHTË ORARIT MËSIMOR

Në kuadër të Programit Kombëtar të Aktiviteteve Jashtë Orarit Mësimor (JOM), Ministrja e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Znj. Bora Muzhaqi, zhvilloi vizita në disa shkolla për të parë nga afër sukseset dhe talentet e nxënësve që janë pjesë e programit "Arte dhe Zeje". Ky program ofron mundësi falas për fëmijët për të zhvilluar dhe shprehur talentet e tyre artistike në një mjedis mbështetës dhe kreativ. Gjatë këtij muaji me qëllim monitorimin e këtij program Ministrja Muzhaqi vizitoi shkollat "Ptoleme Xhuvani" dhe "9 vjeçare Marqinetë". Fëmijët demonstuan aftësitë e reja që kanë mësuar nëpërmjet programit, në aktrim, picture dhe muzikë. Ky program tashmë është zbatuar me sukses në 200 shkolla në të gjithë vendin.

Këto vizita nënvizuan rëndësinë e programeve jashtë orarit mësimor në zhvillimin e aftësive të fëmijëve, jo vetëm në fushën akademike, por edhe në atë personale dhe krijuese, duke i përgatitur ata për një të ardhme më të ndritur dhe të plotë.



REPUBLIKA E ALBANIË
KRIMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Janar



04

PROGRAMI KOMBËTAR I EKIPEVE SPORTIVE NË SHKOLLA, 12 MIJË NXËNËS KANË PËRQAFUAR SPORTET

Gjatë vizitës së fundit në shkollën "Halit Bërzeshta" në Prrenjas, Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Znj. Bora Muzhaqi, u njoh nga afër me entuziazmin dhe angazhimin e të rinjve që janë pjesë e Programit të Ekipeve Sportive në Shkolla.

Programi i Ekipeve Sportive në Shkolla, tashmë në edicionin e tretë, zbatohet në 291 shkolla anembanë vendit, duke përfshirë 826 ekipe sportive në basketboll dhe voleyboll. Qeveria shqiptare mbështet këtë program duke ofruar uniforma, pajisje sportive dhe trajnime të rregullta tre herë në javë. Ky program jo vetëm që zbulon dhe zhvillon talentet në sport, por edhe ndihmon të rinjtë të shpenzojnë kohën e tyre pas orarit mësimor në mënyrë cilësore, duke promovuar një jetë të shëndetshme dhe aktive.



05

NDARJA E ÇMIMEVE PËR "TË RINJTË QË FRYMËZOJNË" – MBRËMJA E KTHYER NË TRADITË PËR TË VLERËSUAR TË RINJTË E DALLUAR.

Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Rinisë, ka organizuar me sukses eventin vjetor "Të Rinjtë që Frymëzojnë". Ky aktivitet ka festuar arritjet dhe talentet e jashtëzakonshme të të rinjve shqiptarë dhe të huaj që jetojnë në Shqipëri, të cilët me përkushtimin dhe veprimtarinë e tyre po kontribuojnë në ndërtimin e një të ardhme më të mirë për shoqërinë. Mbrëmja, e cila tashmë është bërë traditë vjetore, ka mbledhur figura frymëzuese nga fusha të ndryshme si arti, kultura, sporti, teknologjia, edukimi dhe sipërmarrja. Gjatë eventit, u dorëzuan çmimet për të rinjtë e dalluar që kanë bërë ndryshime të rëndësishme në komunitetet e tyre.

Në mes të fjalimeve, performancave artistike dhe momenteve të ndjeshme që theksuan rëndësinë e të rinjve në zhvillimin e shoqërisë, pjesëmarrësit përfshirë personalitete nga bota e artit, kulturës, medias dhe edukimit ndanë histori dhe përvoja frymëzuese. Gjithashtu, u shpërndanë 14 çmime për të rinjtë e dalluar si Benet Bendo, Iris Sula, Distria Krasniqi, Darya Daineka, Rei Dunja, Edmirjano Preçi, Denald Gjata, Lorela Sinani, Raxhi Rakipi, Alis Kallaçi, Orineld Gjini, Fotion Konomi, Mikena Çako dhe Elia Lika - të gjithë të rinj që me veprimet dhe arritjet e tyre po ndikojnë pozitivisht në shoqërinë shqiptare.

